REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA-THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA

Në bazë të Ligjit Nr. 08/L – 197 për zyrtarët publikë, Neni 39 (1,2,3,4,5 dhe 6) dhe Rregullores (QRK) NR. 15/2023 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 5 Komuna Suharekë shpall:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Titulli i pozitës së punës	Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm
Klasa e pozitës	Drejtues i Ulët
Koeficienti/Paga	W9-8.3
Nr. i kërkuar	1
Data e njoftimit	18/01/2024
Afati për aplikim	19/01/2024 - 17/02/2024
Institucioni	Komuna Suharekë
Departamenti	Zyra e Kryetarit
Divizioni	
Vendi i punës	Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm
Nr. i Referencës	RN00013126
Kodi	RPC0006665

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Udhëheq dhe koordinon aktivitetet e pavarurat te NJAB-it me qellim te ngritjes se efikasitetit gjithnjë ne funksion te menaxhimit te rrezikut dhe kontrollues se brendshme;
- Siguron dhe kontrollon sistemin e pajtueshmërisë me Ligjin, perfomancen e procesit ne tersi te Organizatës buxhetore;
- Tek Entitetet e audituar ofron shërbime te shkëlqyeshme këshilluese dhe shërbime te sigurisë objektive e dizajnuar ne drejtimin e përmisimeve me qellim te shtimit te vlerës se procesit te Organizatës buxhetore;
- Mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit përkatës, në fuqi, në lëmin e prokurimit, të buxhetit dhe të financave, ofrimi i këshillave lidhur me sistemin e kontrollimit, zbatimin e sistemeve të reja, dhe përmirësimin e sistemit të auditimit;
- Siguron në përgatitjen e planit strategjik trevjeçar dhe planit vjetor te punës,Raportimet dhe përcjellja e zbatimit te rekomandimeve;
- Siguron qe gjatë procesit te veprimit ne mënyre te detajuar identifikon,konstaton dhe adreson te gjeturat dhe ne mënyrë profesionale bien përfundimet dhe rekomandimet për përmisime te procesit te OB;
- Auditime tjera me kërkesë te kryetarit ne dhënien e opinioneve profesionale ne vlerësimin e mjedisit te kontrollit te brendshëm,rrezikut,ne hartimin dhe përgatitjen udhëzimeve dhe rregulloreve komunale;
- Ofrimi i bashkëpunimit, këshillave dhe ndihmës për Kryetarin Drejtorët e Drejtorive dhe shefave të sektorëve në Komunë mbi çështjet që kanë të bëjnë me auditimin e veprimtarive të cilat janë nën kompetencën e tyre menaxheriale;
- Përgaditja e raporteve për 6 mujorin e parë, dhe 6 mujorin e dytë dhe raportin vjetor të cilat duhen të dorëzohen në afatet kohore në Njësinë Qendrore Harmonizuese për Auditim të brendshëm:
- Kryen edhe auditime at hok sipas kërkesës se Kryetarit të Komunës;

2.Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë, sipas nenit 9 të LZP-së

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve; Fakulteti Ekonomik specializimi financa dhe/apo kontabilitet,Juridik dhe Administratë Publike-(Të diplomuarit jashtë vendit duhet të kenë diplomën e Nostrifikuar nga MASHT-i).
- **Kualifikime të posaçme formale:** Të jetë i qertifikuar me qertifikatë të auditorit të brendshëm në sektorin publik, e leshuar nga Ministria e Financave ose Certifikat për Auditor të brendshëm në Sektorin Publik nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtar apo vendor në pajtim me kriteret e nxjerra nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve;
- **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale.

4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- Njohuri të gjera e të thella të politikave, legjislacionit, procedurave sipas veprimtarisë që mbulon divizioni;
- Aftësi organizative dhe drejtuese për të menaxhuar njësi organizative;
- Aftësi për t'iu përshtatur prioriteteve dhe kërkesave, afateve kohore përmes aftësive analitike dhe zgjidhjes së problemeve;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësinë për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie besimi me eprorin dhe stafin që e menaxhon;
- Aftësi për të motivuar stafin dhe për të menaxhuar me sukses një sërë projektesh të divizionit/departamentit.

5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore;
- Kopje e Certifikatës Auditorit të Brendshëm;
- Kopjet e dëshmisë së punësimit- Kontratë e punës, Vërtetim punësimi (dëshmi shtesë nga Trusti Pensional):
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve;
- Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit (vetëm për zyrtaret publik);
- Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende **(nëse aplikuesi/e ka punuar ose punon në institucione publike);**
- Certifikatë/vërtetim nga Gjykata me të cilin dëshmohet se nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit;

6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për pranim do të shpallet më së largu deri më datën 03/03/2024, në portalin e rekrutimit elektronik (https://konkursi.rks-gov.net)

7.Kriteret specifike shtesë

/////////

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 30 pikë

9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (https://konkursi.rks-gov.net)

10. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (https://konkursi.rks-gov.net)

11. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (https://konkursi.rks-gov.net). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

Udhëzim për aplikim;

Bashkangjitur keni linkun në youtube për mënyrën e aplikimit permes sistemit - platformës;

https://konkursi.rks-gov.net

https://www.youtube.com/watch?v=olwDDqCUeZI

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në LZP.
Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen